



AMBIENTI

KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE

Ndërmarrja Publike Lokale

KRM "Ambienti" Sh. A .Pejë

Njësia Operative Pejë , Klinë, Istog.

Zyret Qendrore Adresë Rr. "Xhemë Sadrija" nr.68 ,Pejë

KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE

"Ambienti" SH.A PEJË

NR

1925

DATA

11.08.2026

Bazuar ne ligjin e Punës: LIGJI Nr. 03/L-212 sipas neni 8,dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ MFPT- NR 01/2024, dhe rregulloren e brendshëm për rregullimin e procedurave te konkursit nr 3090 e datës 21.11.2025 Kryeshefi Ekzekutiv i Kompanisë Regjionale të Mbeturinave "Ambienti" Sh . A .Pejë me datë 12.08.2026, shpall konkurs të jashtëm për këto vende të punës :

KONKURS

Pozita : Automekanik - 1 pozitë

Vendi punës : Pejë

Kohëzgjatja e periudhës provuese është 6 muaj me mundësi vazhdimi sipas kontratave të ligjit të punës.

Koeficienti i pagës : 2.8

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

1. Kryen servisimin e automjeteve, duke përfshirë servisin e obliguar, atë preventiv dhe si pasojë e prishjeve.
2. Kryen riparimin e motorit, ndërruesit, boshtit rrotulluese, diferencialit, frenave punues dhe parkues, sistemit pneumatik të frenimit, si dhe rregullimet që pasqyrojnë rregullsinë teknike të automjetit.
3. Sygjeron shoferin për shfrytëzimin sa më racional të pajisjeve që i nënshtrohen problemeve të shpeshta.
4. Kontrollon gjithëmbarshtëm automjetin, grasaton automjetin sipas udhëzuesit të prodhuesit në pipat e grasatimit, shiqon mbarëvajtjen e pompave të presionit, sistemin e drejtimit, sistemin e emitimit të gazrave, etj.
5. Teston dhe provon rregullsinë e motorit.
6. Punon në riparimin gjeneral dhe riparimet tjera te të gjitha llojeve të makinerive dhe automjeteve të kompanisë.
7. Është përgjegjës për problemet mekanike të automjeteve, si rezultat i mos aktivitetit të tij për sanim.
8. Është përgjegjës për kryerjen me kohë dhe në mënyrë profesionale të punëve.
9. Është përgjegjës në rast të humbjeve të mjeteve të punës, punëtori do të përgjigjet materialisht.
10. Sipas nevojës bën intervenimin e automjeteve në terren.
11. Është i obliguar të mbajë uniformën e ndërmarrjes dhe pajisjet e tjera të punës dhe mbrojtjes në punë.
12. Kryen punë bazuar në kontratën e punës, por edhe punë tjera me urdhëresë të kryepunëtorit dhe me sygjërime të menaxherit të operativës.
13. Për mosrespektimin e pikave të lartcekura i përgjigjet drejtpërdrejt Kryeshefit Ekzekutiv.

a. Kushtet e përgjithshme :

- CV;
- Çertifikatë që kandidati nuk është nën hetime;
- Letër motivimi;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Çertifikatë mbi gjendjen shëndetësore.

b. Kushtet e veçanta :(kualifikimet profesionale)

- Shkolla e mesme, përparësi drejtimi automekanik;
- Përparësi përvojë pune e dëshmuar;
- Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë;



AMBIENTI

KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE

Ndërmarrja Publike Lokale

KRM "Ambienti" Sh. A .Pejë

Njësia Operative Pejë , Klinë, Istog.

Zyret Qendrore Adresë Rr. "Xhemë Sadrija" nr.68 ,Pejë

Pozita : Punëtor i Mbledhjes së Mbeturinave dhe Mirëmbajtjes- 2 pozitë

Vendi punës : Pejë

Kohëzgjatja e periudhës provuese është 6 muaj me mundësi vazhdimi sipas kontratave të ligjit të punës.

Koeficienti i pagës : 2.3

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

1. Kryen të gjitha punët në mbledhjen dhe ngarkimin e mbeturinave.
2. Mbledh mbeturinat dhe bën zbrazjen e kontejnerëve dhe mjeteve të tjera për hedhurina apo qeseve nga shfrytëzuesit e shërbimeve në sektorin privat dhe shtetëror.
3. Pas zbrazjes së kontejnerëve dhe mjeteve tjera, është i obliguar t'i kthej ato në vende të caktuara dhe të kujdeset për to.
4. Është përgjegjës për kryerjen e punëve në mënyrë efikase dhe kualitative, për sjellje korrekte me qytetarët-shfrytëzuesit e shërbimeve.
5. Është i obliguar të mbaj uniformën e ndërmarrjes dhe pajisjet e tjera të punës dhe mbrojtjes në punë (PPM).
6. Kryen punë bazuar në kontratën e punës por edhe punë tjera me urdhëresë të shoferit, kryepunëtorit, koordinatorit operativ dhe menaxherit operativ.
7. Për mosrespektimin e pikave të lartcekura i përgjigjet drjtëpërdrejt Kryeshefit Ekzekutiv.

a. Kushtet e përgjithshme :

- CV;
- Çertifikatë që kandidati nuk është nën hetime;
- Letër motivimi;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Çertifikatë mbi gjendjen shëndetësore.

b. Kushtet e veçanta :(kualifikimet profesionale)

- Të ketë njohuri për shkrim dhe lexim përparësi shkollimi fillor;
- Aftësi fizike dhe psikike të dëshmuar;
- Përparësi përvojë pune e dëshmuar;
- Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë.

Mënyra e Aplikimit : Dokumentacioni duhet të dërgohen ne e-mailit konkurset@ambienti-sha.com

Data e për aplikim është nga 12.08.2026 deri me 27.08.2026 ora 12:00. Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm.. Dokumentet origjinale mund të kërkohen, sipas nevojës. Vetëm kandidatët e selektuar për listën e ngushtë do të kontaktohen.